

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-176/2020	Data: Datum: 04.05.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, shqyrtoi kërkesën Nr 01-016-10472 të datës 14.04.2020 të parashtruar nga Jeta Balaj Imeraj nga Istogu, për lejimin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Jeta Balaj Imeraj, e caktuar në punët dhe detyrat, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
2. Pushimi, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me: 30.04.2020 e deri më: 30.01.2021, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 31.01.2021
3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, pra prej (30.04.2020 deri me 30.10.2020) paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës dhe 3 muajt në vijim prej (30.10.2020 deri me 30.01.2021) paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunësve civile.

A r s y e t i m

Jeta Balaj Imeraj, e caktuar në punët dhe detyrat, Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun, ka parashtruar kërkesën Nr 01-016-10472 të datës 14.04.2020 me të cilën ka kërkuar lejimin e pushimit të lehonisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nënparagrafin 1.3 të paragrafit 1 të nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, punëtores i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzojë sipas dëshirës.


Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në nënparagrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil të mos e shfrytëzojë, mirëpo është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë mujor të njoftoj: Menaxherin e Personelit, se nuk dëshiron të shfrytëzojë pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Punëtores gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Jeta Balaj Imeraj, Menaxheri i Personelit, Përgjegjësjë për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
 z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-178/2020	Data: Datum: 06.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), Duke u bazuar në Vendimin e qeveris së Republikës së Kosovës Nr.239/IV/2020, për gjendjen aktuale të krijuar në të gjithë vendin po ashtu edhe tek ne, po ashtu edhe gjendjen e krijuar në komunën e Istogut, që ti dalim në ndihmë Fermerëve dhe Bujqve, nxjerr:

V E N D I M

PËR HAPJEN DHE FUNKSIONALIZIMIN E TREGUT TË GJELBETË

1. Lejohen hapja dhe funksionalizimi i pjesëritshëm i tregut të gjelbër të Komunës së Istogut, për bujqit dhe fermerët për shitjen e produkteve bujqësore sezonale: kulturave perimtarie (Pemët, Perimet dhe fidane).
2. Të gjithë Bujqit dhe Fermerët të cilët do ti ekspozojnë produktet e tyre obligohen që t'i respektojnë rekomandimet e IKSHP-së kundër COVID-19 siç janë: mbajtja e distancës sociale prej 2 metra dhe përdorimi i maskave dhe dorëzave.
3. Obligohet Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që të hartoj Planin Operativ për funksionimin e tregut siç është: caktimi i orarit për shitjen.
4. Obligohet Drejtoria e Inspektoratit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që të bëjnë inspektimin dhe mbarëvajtjen e funksionimit të tregut.

Arsyetim

5. Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar në Republikën e Kosovës pas paraqitjes së pandemisë së COVID 19 si dhe mungesës së tregjeve për ekspozimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore nga ana e fermerëve të Komunës së Istogut, është parë e arsyeshme që hapësira e tregut të gjelbërit, të funksionalizohet pjesërisht për t'iu mundësuar fermerëve bujqësor shitjen e prodhimeve bujqësore, kulturave bujqësore sezonale.
Duke marrë parasysh hapësirën e mjaftueshme të tregut, konsiderojmë se fermeret bujqësor do të mund t'i ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre sezonale duke respektuar mjaftueshëm masat e rekomanduara nga IKSHP për mbajtje të distancës, maskave dhe dorëzave.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me kopje të Vendimit të njoftohet: Drejtoria e Inspektoratit dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Stacioni Policisë së Istogut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-179/2020	Data: Datum: 06.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për caktimin e mbikëqyrësit për realizimin e projekteve: "Riparimi i Bus Stacioneve në Territorin e Komunës së Istogut", me numër të brendshëm prokurimi 633/20/006/536, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** mbikëqyrës **Naser Gjoci**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, në Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, për projektin "Riparimi i Bus Stacioneve në Territorin e Komunës së Istogut", me numër të brendshëm prokurimi 633/20/006/5361, të cilin është duke e realizuar operatori "7 ING O.P" SHPK nga Raushiqi, me Nr. Rexh. Biznesi,810397308.
2. I lartpërmenduri do të bëjë mbikëqyrjen e realizimit të projektit të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi sipas projekti detal ekzekutive; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punëve; do të njoftoj Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e punimeve sipas projektit të cekur dhe me vështirësitë eventuale që paraqiten gjatë mbikëqyrjes së punëve, si dhe do t'i kryejë edhe punë dhe detyra e tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij kujdeset: Mbikëqyrësi i projektit, Prokurimi dhe Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimit të njoftohen: Naser Gjoci, operatori "7 ING O.P" SHPK, Drejtorin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Z. Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-181/2020	Data: Datum: 08.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Loto 1 "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Baicë - faza II" Loto 2 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Lubovë" Loto 3 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Corollukë" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në lagjen "Maksutaj - Hajrizaj" në fshatin Orrobërdë", me numër të brendshëm prokurimi 633/20/012/521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektet Loto 1 "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Baicë - faza II" Loto 2 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Lubovë" Loto 3 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Corollukë" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në lagjen "Maksutaj - Hajrizaj" në fshatin Orrobërdë", me numër të brendshëm prokurimi 633/20/012/521 dhe në komision caktohen:

1. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
2. **Blerim Bujupi**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
3. **Tahir Maksutaj**, Zyrtar për Siguri të Përgjithshme, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Loto 1 "Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Baicë - faza II" Loto 2 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Lubovë" Loto 3 "Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Corollukë" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në lagjen "Maksutaj - Hajrizaj" në fshatin Orrobërdë", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit e tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe zyra e Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


 Kryetari i Komunës
Z. HAKI RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-183/2020	Data: Datum: 12.05.2020	

Projekt – Rregulloren Komunale të Kodit të Etikës

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 11, 13, 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), dhe nenin 10, paragrafi 5 i Rregullores Komunale për punën e Kuvendit të Komunës së Istogut Nr.2/2013, duke pasur parasysh nevojën për hartimin e Projekt – Rregullores Komunale për Kodin e Etikës, murrë këtë:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** komisioni për Projekt – Rregulloren Komunale për Kodin e Etikës, dhe në këtë komision caktohen:

1. **Edona Bujupi-Loxha**, Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë, Kryesuese e Komisionit;
2. **Hysni Maxharraj**, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, anëtar;
3. **Lulzim Blakaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar,
4. **Hazbi Bajra**, Shef i kabinetit të Kryetarit, anëtar;
5. **Fatmir Bytyqi**, Menaxher i Personelit, anëtar,
6. **Zekie Sutaj**, Udhëheqëse e Sektorit Ligjor, anëtare;
7. **Vjosa Hysenaj**, Zyrtare e lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të komunës, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë hartimin e Projekt – Rregullores Komunale të Kodit të Etikës me ecurinë e punës së komisionit do të njoftojë rregullisht Kryetarin dhe pas përfundimit kopjen e Projekt-Rregullores së cekur me lartë do të dorëzohet Kryetarit. Ky komision do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit që janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Komisioni do të fillojë me punë menjëherë, dhe të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Drejtoria për Administratë.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Administratë dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
 Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-184/020	Data: Datum: 13.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektin: **“LOTO1-Ndertimi i rrugëve në Lluga-Lagja Balaj. LOTO2-Ndertimi i rrugëve në lagjet Metaj dhe Lipaj në Kamenicë. Loto3-Ndertimi dhe rregullimi i rrugëve ne Rakosh. LOTO4-Ndertimi i rrugës Lagja Igshitaj-Bellopoje”** me numer të brëndshëm prokurimi 633/020/015/521, nxjerr:

V E N D I M

- FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit me nr: 633-20-1380-5-2-1. **“LOTO1-Ndertimi i rrugëve në Lluga-Lagja Balaj. LOTO2-Ndertimi i rrugëve në lagjet Metaj dhe Lipaj në Kamenicë. Loto3-Ndertimi dhe rregullimi i rrugëve ne Rakosh. LOTO4-Ndertimi i rrugës Lagja Igshitaj-Bellopoje”**, dhe në komision caktohen:
 - Naser Gjoci, Udh. Për Sherbime Publike, Kryesues i Komisionit;
 - Hekuran Rugova, Zyrtar për hartimin e Projekteve, anëtar.
 - Gezim Ademaj, Zyrtar për Prokurim, anëtar.
- Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për projektin **“LOTO1-Ndertimi i rrugëve në Lluga-Lagja Balaj. LOTO2-Ndertimi i rrugëve në lagjet Metaj dhe Lipaj në Kamenicë. Loto3-Ndertimi dhe rregullimi i rrugëve ne Rakosh. LOTO4-Ndertimi i rrugës Lagja Igshitaj-Bellopoje”**, si dhe do t'i kryej punët dhe përgjigjesit tjera të cilat janë në natyrën e ketij komisioni .
- Vlersimin i ofertave do ta kryej Komisioni mbrenda tri ditëve të punes dhe për punën e kryer do ti raportoj Kryetarit të Komunes.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-189/2020	Data: Datum: 18.05.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe bazuar në Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës, shqyrtoj kërkesën Nr.01-400-10857 të datës 05.05.2020 e parashtruar nga OJQ "ABA" nga Istogu, për përkrahje financiare dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-10857 të datës 05.05.2020 e parashtruar nga OJQ "ABA" dhe i ndahen mjetet financiare në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, mallra dhe shërbime nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit të Komunës. Pasi që gjendja aktuale me Covid 19 i ka pamundësuar punën dhe OJQ-ja punën e kryen në një lokal me qira dhe duhet të paguhet qiraja për tre muajt: Mars, Prill, Maj, gjë që OJQ-ja nuk ka mundur të i siguroj këto mjete.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "ABA", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Ky vendim është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: OJQ "ABA", Zyra e Kryetarit të Komunës dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-190/020	Data: Datum: 18.05.2020	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, shqyrtoj kërkesën e drejtorit të drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për formimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 06 nr.73/2020 të datës 14.05.2020, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 06Nr.73/2020 të datës 14.05.2020, për vendin e punës: Mjekë të mjekësisë së Përgjithshme, 3(tre) ekzekutues dhe 1(një) Specialist Gjinekolog, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në komision caktohen :
 1. **Dr.Ekrem Berisha** – Biokimist, shëf i shërbimit Diagnostikes, Kryetar i komisionit.
 2. **Dr.Egzonë Hajzeraj-Hoxhaj** – Mjekë e Mjekësisë së Përgjithshme, anëtare,
 3. **Dr.Veton Kurti** - Mjekë e Mjekësisë së Përgjithshme, anëtar.
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për vendin e punës: Mjekë të mjekësisë së Përgjithshme, 3(tre) ekzekutues, dhe 1(një) Specialist Gjinekolog, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në pajtimin me procedurat e ligjit të punës Nr.03/L-212,dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftoj Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale .
4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

Me nga një kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale dhe një kopje të mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-192/2020	Data: Datum: 20.05.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) dhe në bazë të nenit 18, paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe nenin 7, me qëllim të intervistimit të kandidatëve që kanë konkurruar sipas konkursit 02 Nr.32/20, të datës 12.05.2020 nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkursin 02 Nr.32/20, të datës 12.05.2020, për pozitën, **Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte - subvencione** (marrëveshje për shërbime të veçanta - në kohëzgjatja 3 muaj) 3 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe në të caktohen:
 1. Hasan Maxharraj, Zyrtar për Zhvillim të Bujqësisë, kryesues;
 2. Kushtrim Zogaj, Zyrtar i Lartë për politika Bujqësore dhe Tregje , anëtar;
 3. Fjollë Berisha, Zyrtare për Informim dhe Monitorim të Medieve, anëtare;
 4. Vjosa Hysenaj, Zyrtar e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës, anëtar, dhe
 5. Abedin Neziraj, Zyrtar për Kthim të Qëndrueshëm, anëtar.
2. Komisioni i cekur do të mbajë intervistimin me kandidatët të cilët kanë konkurruar për pozitën, Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte - subvencione (marrëveshje për shërbime të veçanta - në kohëzgjatja 2 muaj) 4 ekzekutues, në kuadër të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi në pajtim me procedurat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me listën e ngushtë të kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të njoftojnë udhëheqësin e personelit për procedim të mëtejshëm.
3. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë, zyra e personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen anëtarët e komisionit.

Me nga një kopje të këtij Vendimi të njoftohen: anëtarët e komisionit, menaxheri i personelit dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
 z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-193/2020	Data: Datum: 21.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Loto 1 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Lluga - Lagja "Balaj", Loto 2 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Kamenicë Lagja "Metaj dhe Lipaj", Loto 3 "Ndërtimi dhe Rregullimi i Rrugëve në fshatin Rakosh" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në fshatin Bellapojë lagjen "Igrishaj", me numër të brendshëm prokurimi 633-020-015-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektet Loto 1 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Lluga - Lagja "Balaj", Loto 2 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Kamenicë Lagja "Metaj dhe Lipaj", Loto 3 "Ndërtimi dhe Rregullimi i Rrugëve në fshatin Rakosh" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në fshatin Bellapojë lagjen "Igrishaj", me numër të brendshëm prokurimi 633-020-015-521, në komision caktohen:

1. **Genc Ademaj**, Zyrtar i Lartë për Vlersim të Projekteve për Partneritetin Publiko Privat, Kryesues i Komisionit;
2. **Fjolle Berisha**, Zyrtar për Informim dhe monitorim të Mediave, anëtar dhe
3. **Hekuran Rugova**, Zyrtar për Hartimin dhe Përcjelljen e Projekteve Kapitale, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Loto 1 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Lluga - Lagja "Balaj", Loto 2 "Ndërtimi i Rrugëve në Fshatin Kamenicë Lagja "Metaj dhe Lipaj", Loto 3 "Ndërtimi dhe Rregullimi i Rrugëve në fshatin Rakosh" dhe Loto 4 "Ndërtimi i rrugës në fshatin Bellapojë lagjen "Igrishaj", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit e tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe zyra e Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-194/2020	Data: Datum: 21.05.2020	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektet: Lloto 1 "Betonimi i Kanalit Vërshues të Rudeshit në fshatin Vrellë " Lloto 2 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Vrellë dhe Lubovë" dhe Loto 3 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Lagjet " Kabashi dhe Bajramaj" në fshatin Gurrakoc", me numër të brendshëm prokurimi 633-020-016-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **FORMOHET:** Komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit për projektet Lloto 1 "Betonimi i Kanalit Vërshues të Rudeshit në fshatin Vrellë " Lloto 2 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Vrellë dhe Lubovë" dhe Loto 3 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Lagjet " Kabashi dhe Bajramaj" në fshatin Gurrakoc", me numër të brendshëm prokurimi 633-020-016-521, dhe në komision caktohen:

1. **Beqir Metaj**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryesues i Komisionit;
2. **Shefqet Imeraj**, Zyrtar i Prokurimit 1, anëtar dhe
3. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i lartë për Infrastruktur Rrugore, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterëve të paraqitur në dosjen e tenderit për projektet: Lloto 1 "Betonimi i Kanalit Vërshues të Rudeshit në fshatin Vrellë " Lloto 2 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Vrellë dhe Lubovë" dhe Loto 3 "Betonimi i Kanalit të ujitjes në Lagjet " Kabashi dhe Bajramaj" në fshatin Gurrakoc", si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit e tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisionit dhe zyra e Prokurimi.

Me kopje të Vendimit të njoftohen: Komisioni, Prokurimi, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Z. Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-220/2020	Data: Datum: 28.05.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 61 paragrafi 61.4, 61.15 dhe neni 9 paragrafi 9.1 shkronja g). Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik i miratuar me datën 01.11.2016 nga KRPP-ja legjislaion dytësor, për caktimin e Menaxherit të kontratës për projektin: "Blerja dhe Instalimi i Pompave Termike në SHMT "Mithat Frasheri" në Gurrakoc" me numër të brendshëm prokurimi 633-020-005-221, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxher i kontratës, Isa Hoxhaj, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, për projektin: "Blerja dhe Instalimi i Pompave Termike në SHMT "Mithat Frasheri" në Gurrakoc" me numër të brendshëm prokurimi 633-020-005-221, të cilën është duke e realizuar operatori "ADETEX SHPK" nga Prishtina.
2. I lartpërmenduri do të jetë Menaxher i kontratës të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të menaxhoj realizimin e kësaj kontrate, do të njoftojë Kryetarin rregullisht lidhur me realizimin e kontratës si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera që janë të natyrës së tillë.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset: Menaxheri i kontratës.
4. Vendimi është përfundimtar.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Isa Hoxhaj, Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpetim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe një kopje mbetet në arkivin e zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
 z. Haki RUGOVA





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

**KRYETARI I KOMUNËS
PREDSIEDNIK OPŠTINE
MUNICIPAL MAYOR**

Nr.Br. 01-223/2020

Data:
Datum:
29.05.2020



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008). Nenit 40 paragrafit 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, shqyrtoi kërkesën Nr 01-016-12198 të datës 28.05.2020 të parashtruar nga Alketa Bytyqi nga Istogu, për lejin e pushimit të lehonisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Alketa Bytyqi, e caktuar në punët dhe detyrat, Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
2. Pushimi, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi fillon me: 29.05.2020 e deri më: 30.02.2021, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 30.02.2021
3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, pra prej (29.05.2020 deri me 29.11.2020) paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës dhe 3 muajt në vijim prej (29.11.2020 deri me 30.02.2021) paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunësve civile.

A r s y e t i m

Alketa Bytyqi, e caktuar në punët dhe detyrat Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryetarit, ka parashtruar kërkesën Nr 01-016-12198 të datës 28.05.2020 me të cilën ka kërkuar lejin e pushimit të lehonisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 40 paragrafit 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.72/2010), bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, punëtores i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzojë sipas dëshirës.

Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në nënparagrafin 2.2 të paragrafit 2 të nenit 12 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil të mos e shfrytëzojë, mirëpo është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë muaj të njoftoj: Menaxherin e Personelit, se nuk dëshiron të shfrytëzojë pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Punëtores gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese. Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Alketa Bytyqi, Menaxheri i Personelit, Përgjegjësjë për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Kryetari i Komunës
z. Haki RUGOVA

[Signature]

